

MANUAL PËR PLOTËSIMIN E VROJTIMIT PILOT (TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE)

Qëllimi i vrojtimit të transportit rrugor të mallrave është të mbledhë dhe të ofrojë të dhëna statistikore të besueshme dhe të harmonizuara mbi aktivitetin e transportit të mallrave me mjete rrugore, kamionë dhe traktorë rrugorë – me një kapacitet ngarkese prej të paktën (3,5 ton), si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Këto të dhëna përdoren për të vlerësuar volumin e mallrave të transportuara, lëvizjen e tyre sipas llojit të mallrave, distancës dhe zonave gjeografike, si dhe për të ndihmuar në hartimin e politikave për infrastrukturën rrugore, zhvillimin ekonomik, dhe mbrojtjen e mjedisit.

Fusha e Mbulimit: Të gjithë kamionët dhe traktorët rrugor që kryejnë aktivitet ekonomik në të gjithë territorin e Shqipërisë, për të gjitha format ligjore dhe llojet e pronësisë.

Si të plotësohet pyetësi

Faqja e parë

Ju lutemi kontrolloni me kujdes detajet e vendosura në faqen e parë të pyetësit, duke përfshirë emrin / adresën tuaj dhe detajet e automjetit që është zgjedhur për vrojtimin. Nëse gjeni ndonjë mospërputhje midis detajeve tuaja aktuale dhe detajeve (siç është regjistruar në regjistrin e automjeteve) të automjetit, ju lutemi shkruani detajet e duhura në kutitë përkatëse.

Faqja 3 ose 4 duhet të plotësohet për ato automjete, për të cilat pronari / personi që ka mjetin në përdorim, ka marrë një ngarkesë në javën e vrojtimit. Ju lutemi shkruani detajet e kërkuara vetëm për javën e vrojtimit.

Statusi i automjetit të përzgjedhur për javën e vrojtimit

Automjeti i disponueshëm (nënkupton edhe automjetin jashtë funksionit në javën e vrojtimit, por në dispozicion të personit/ndërmarrjes.

Automjeti i shitur para javës së vrojtimit.

Automjeti i marrë me qira për një periudhë më të gjatë se 1 muaj.

Automjeti i c'është regjistruar para javës së vrojtimit.

Tjetër.

Faqja e dytë:

1. Përshkrimi i aktivitetit të kryer nga shoqëria ose personi që ka mjetin në përdorim.

Traktor rrugor: mjet i cili nuk ka karrocë për mallra vetë, por shërben për të tërhequr ngarkesa që janë në një rimorkio të ndarë.

2-5. Plotësimi i karakteristikave të mjetit

6. Kilometrat e përshkruara në 12 muajt e fundit ose nga periudha kur automjeti është në pronësi, në rast se automjeti është në pronësinë tuaj për më pak se 12 muaj plotësohet kutia e dytë me numrin e muajve.

7. Arysja e përdorimit të mjetit: Nëse mjete është përdorur për qira/shpërblim ose për llogarinë e vet.
8. Shkruani në këtë fushë numrin e ditëve të automjetit që është përdorur për transport mallrash (a,b dhe c) dhe jashtë shërbimit (d deri i) gjatë javës së vrojtimit.
9. Lënda djegëse e blerë gjatë javës së vrojtimit, shuma në litra sipas llojit të karburantit.

Faqja e tretë dhe e katërt

Udhëtimet gjatë javës së vrojtimit

Faqja e tretë plotësohet rregullisht, në mënyrë kronologjike, për të gjitha ditët e aktivitetit të automjeteve gjatë javës së vrojtimit deri në 4 ndalesa. Për udhëtime me disa ndalesa shkruani secilën fazë të udhëtimit ndërmjet ndalesave në një rresht të veçantë (për shembull, një udhëtim nga A në B, pastaj nga B në C, pastaj nga C në D duhet të futet në tre rreshta të veçanta për të treguar secilën fazë të udhëtimit).

Faqja e katërt plotësohet për të gjitha ditët e aktivitetit të automjeteve gjatë javës së vrojtimit me 5 ose më shumë ndalesa.

Rregullat e përgjithshme për faqen e tretë dhe të katërt të pyetësorit

- **Në kolonën 1** shkruani datën e nisjes për udhëtim.
- **Në kolonën 2-3** shënohet emri i plotë dhe i saktë i bashki / qark nëse nisja është kryer nga Shqipëria, nëse nisja kryhet nga një shtet tjetër shënohet dhe emri i shtetit tjetër. Nëse automjeti ka ofruar shërbim në ndërtimin e rrugëve ose në bujqësi, shënoni emrin e bashki / qark ku ndodhet vendi i aktivitetit. Nëse udhëtimi përfshin tranzitin e një vendi të huaj dhe / ose transportimin e automjetit, për një pjesë të udhëtimit, me një mënyrë tjetër transporti (për shembull, përdorimi i një trageti ose treni) nuk shënohet kjo pjesë e transportit.
- **Në kolonën 4** shkruani peshën (në ton) të ngarkesës së ngarkuar në automjet, me një shifër pas presjes(për shembull, 10.0 ton ose 6.3 ton). Nëse një peshë e saktë nuk është e disponueshme, bëjeni vlerësimin tuaj më të mirë. Për udhëtime boshe (pa ngarkesë) shkruani 0.
- **Në kolonën 5** shkruani distancën e përshkruar në kilometra jepni një vlerësim sa më të përafërt në rast se nuk e keni të saktë distancën e kryer.
- **Në kolonën 6** vendosni Po ose Jo nëse keni kryer një lloj tjetër transporti për kryerjen e udhëtimit.
- **Në kolonën 7-8-9** shkruani përshkrimin e ngarkesës së ngarkuar dhe shkaruar në automjet. Për disa lloje të ngarkesave të ngarkuara në automjetin e makinës shkruani llojin e peshës më të madhe.
- **Në Kolonën 10** për transportin e mallrave të rrezikshme. Këtu shënoni kodin përkatës duke përdorur përkufizimet e mëposhtme (Secila kategori është ose një klasë ose një ndarje e një klase të ADR - Traktati European mbi transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme). **Për mallrat jo të rrezikshme të bartur shkruani 0.**

1. Eksploziv
2. Gaze, të ngjeshur, të lëngëzuar ose të tretur nën presion
3. Lëngjet të ndezshme

- 4.1 Lëndë të ngurta të ndezshme
- 4.2 Substanca që janë të priura për vetëndezje
- 4.3 Substanca që në kontakt me ujin lëshojnë gazra të ndezshëm
- 5.1 Substancat oksiduese
- 5.2 Peroksidet organike
- 6.1 Substancat toksike
- 6.2 Substancat që mund të shkaktojnë infeksione
- 7. Substanca radioaktive
- 8. Substanca korrozive/gërryese
- 9. Substanca të ndryshme të rrezikshme

- **Në kolonën 11** shkruani llojin e ngarkesës duke përdorur përkufizimet e mëposhtme:

0-Mallrat e lëngshme pjesa më e madhe

1-Pjesa më e madhe të ngurta

2-Kontejnerë të mëdhenjë të mallrave

3-Kontejnerë të tjerë mallrash

4-Mallra të paletizuar

5-Mallrat të prera

6-Njësi të lëvizëshme, vetëlëvizëse dhe kafshët e gjalla

7-Njësitë tjera të lëvizshme

9-Llojet të tjera ngarkesash

- **Në kolonën 12** shkruani shkallën e ngarkimit: 0 automjeti bosh, 1 jo plotësisht i ngarkuar më pak se 90%, 2 ngarkuar plotësisht mbi 90%, 9 e panjohur pesha.
- **Në kolonën13** shënoni kodin 1 ose 2 në varësi të llojit të transportit nëse është kryer për llogarinë e vetë personit ose është i punësuar.
- **Në kolonën 14** shkruani numrin e udhëtimeve

	Data	Emri i bashkisë/qarku (për transport ndërkombëtar shkruani emrin e shtetit të huaj). Në rreshtin e mëposhtëm shkruani emrat e shteteve tranzit.				*Një mënyrë tjetër transporti (1 – PO, 2 – JO)	Pesha e mallrave të ngarkuar, Tonë	Pesha e mallrave të shkarkuar, Tonë	**Lloji i mallit (Malli me peshën më të madhe të shkarkuar)	Kodi i klasës së mallrave të rrezikshme (shkruaj kodin)	Lloji i ngarkesës shkruani kodin)	Shkalla e ngarkimit (shkruani kodin)	Statusi i punësimit të drejtuesit të mjetit 1 - punësuar 2 – llogarinë e vet	Numri i udhëtimeve
		Vendi i nisjes	Vendi i destinacionit	Momenti i nisjes 1-Ngarkuar (shkruani peshën në tonë) 2-Bosh (vendosni 0)	Distanca e përshkuar, km									
	22/05	Tirane	Verona,Itali	0	480	Po	3.5		Birra	0	1	2	1	1
	24/05	Verona,Itali	Tirane	3.5	480	Po		3.5	Birra	0	1	0	1	1

*-Një mënyrë tjetër transporti (nëse mjeti që kryen transportin është transportuar vetë psh traget, tren)

** -Në rast kur dy mallra kanë të njëjtën peshë vendosni mallin që transportoni më shpesh midis tyre